



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË



Komiteti për Politikë dhe Financa

Nr. 02/ *311*

Datë: 18.06.2021

Procesverbal

i mbledhjes se I (parë) të jashtëzakonshme për vitin 2021 të Komitetit për Politikë dhe Financa

REND I DITES

1. Shqyrtimi i kërkesave.

Mbledhja u mbajt me datë: 23.04.2021 duke filluar në ora 13:30, morën pjesë 7 anëtarë të KPF-së, zyra për informim.

Rrahim Morina: Ju përshëndes të gjithëve kemi vetëm një pikë të rendit të ditës, as nuk shtohet as nuk hiqet. A pajtoheni me këtë rend dite? Unanimisht ishin për

1. Shqyrtimi i kërkesave

Kërkesa 02/78 dt.02.03.2021 Sahdete Lugu nga fshati Pagarushë Komuna e Malishevës e operuar në idhëz.

Alban Krasniqi: Ka kërkesa të shumta dhe nga përshkrim të kërkesave ne po ballafaqohemi me problemin e vërtetësisë së kërkesave edhe se çfarë lloji ndihme mund t'i japim ne aspektin monetar. Ty pas këto probleme mendoj të trajtojmë se paku vërtetësinë e dokumenteve, kurse të shumta me marr një vendim me nga 500 euro.

Raimonda Krasniqi: Kur behët fjale për gjendjen shëndetësore askush nga qejfi nuk kërkon njëjtë, pra gjendja e disa qytetarëve është alarmante, mirë është me ditë se a kanë marrë ndonjëherë ndihmë nga kryetari i Komunës. Jam t'i ndajmë nga 500 euro secilit nëse biem dakord, por ndoshta dikush nga ta e ka gjendjen me të rëndë se dikush tjetër.

Rrahim Morina: Nëse verifikohet se dikush a ndihmuar nga kryetari unë do ta anuloj vendimin kush do qoftë aj që ne ndihmojmë.

Halil Morina: Shqetësimet e përmendura janë të arsyeshme dhe qëndrojnë në to, problemi i sigurisë që ne nuk kemi mekanizëm që vërteton sëmundjen e një qytetari përveç nëse e njohim ndonjë. Te shumta e mjeteve është problematike nëse shkojmë njëjtë, ose rastet mundën mos me qenë të njëjta, e jo për një therr në këmbë me ndihmuar, nëse janë të natyrës së njëjtë kërkesat t'i ndihmojmë me nga 500 euro.

Valon Krasniqi: Ty pas parasysh të kaluarën sa i përket këtyre kërkesave të qytetarëve drejtuar neve, nëse dikush a ndihmu nga kryetari mos të ndihmohen nga Kpf. Më herët një nxënëse e kemi pas votuar ne e s'është implementuar vendimi se thanë ka kërkuar edhe nga kryetari i Komunës edhe pse Elsa është dashtë të ndihmohet se na ka bërë krenar si Malishevë, sepse në gara të Fizikës ka pas zë vendin e dytë.

Rrahim Morina: Dy kërkesa ishin me kancer në gji mandej intervenim edhe në fyt, në organe të tretjes pra janë të natyrave të ndryshme. Unë jam të gjithë të ndihmohen nga 500 euro.

Alban Krasniqi: Janë shumë kërkesa sepse dikund 17 kërkesa ishin, tani kur të jetë zbraztë buxheti përnime dikush ka me pas nevojë e duhet me ba krejt zgjidhje tjera me siguru mjete. Ajo që po na mungon është se ne si Kpf me kerku me ba një kolegji te mjekëve me shqyrtua dokumentacionin

edhe një jurist e tani pastaj ne mundemi me marrë ndonjë vendim. Me vendose nga 500 euro në krijojmë barazi mes rasteve që s'janë të barabarta. Në vendim kur tju ndahet a nënshkruajnë këta

njerëz dikund. Duhet me kanë një akt pranueshmerie se ata e marrin përsipër vërtetësinë e të dhënave që na kanë dërguar neve dhe për çfarëdo pa vërtetësie bartin përgjegjësinë e tyre penale në raport.

Rrahim Morina: Jo vetëm e sjellin konfirmimin bankar.

Raimonda Krasniqi: Në rastin kur paratë ju dalin në llogari bankare a ka ndonjë dokument që tregon se i pranojnë mjetet palët.

Filloreta Bytyqi: Krejt janë me probleme përafërsisht të njëjta, gjinekologjike, me diabet e tjera.

Valon Krasniqi: Kur llogarisim minimumin 500 euro pajtoj edhe unë kësaj radhe të shkojmë me minimum 500 euro për secilin.

Alban Krasniqi: secili rast që ne ndihmojmë të vërtetohet se a është ndihmuar nga Komuna.

Rrahim Morina: A jeni që secili të ndihmohet me nga 500 euro e nëse ju dëshironi unë edhe ju lexoj kërkesat.

-kërkesa nr.02/185 datë:19.04.2021 e parashtruar nga z.Defrim Gashi nga fshati Vermicë Komuna e Malishevës, për mbështetje financiare për trajtim shëndetësor të djali të tij të sëmurë Plator Gashi.

-Kërkesa nr.02/186 datë: 19.04.2021 e parashtruar nga zj. Nura Krasniqi me vendbanim në Malishevë, për mbështetje financiare për trajtim shëndetësor.

-Kërkesa nr.02/180 datë:15.04.2021 e parashtruar nga zj. Zela Krasniqi me vendbanim nga fshati Dragobil Komuna e Malishevës, për mbështetje financiare për përcjellëse të vajzës së saj të sëmurë znj. Shpresa Paqarizi nga fshati Dragobil.

-Kërkesa nr.02/183 datë:16.04.2021 e parashtruar nga z. Rexhep Gegaj nga fshati Lladroc Komuna e Malishevës, për mbështetje financiare për trajtim shëndetësor të vajzës së tij Melisa Gegaj.

-Kërkesa nr.02/184 datë: 16.04.2021 e parashtruar nga zj. Antigone Gashi me vendbanim në fshatin Balincë, Komuna e Malishevës për mbështetje financiare për trajtim shëndetësor.

-Kërkesa nr.02/179 datë: 14.04.2021 e parashtruar nga zj. Elfete Zogaj nga fshati Bellanicë, Komuna e Malishevës për mbështetje financiare për trajtim shëndetësor.

-Kërkesa nr.02/159 datë: 07.04.2021 e parashtruar nga znj. Besartë Mazreku nga fshati Ngucat, me vendbanim në Malishevë për mbështetje financiare për trajtim shëndetësor.

-Kërkesa nr.02/158 datë: 07.04.2021 e parashtruar nga zj. Albinë Bytyçi nga fshati Millanoviq, Komuna e Malishevës për mbështetje financiare për trajtim shëndetësor.

-Kërkesa nr.02/155 datë: 06.04.2021 e parashtruar nga zj. Shqiponjë Zogaj nga fshati Turjakë , Komuna e Malishevës për mbështetje financiare për trajtim shëndetësor.

-Kërkesa nr.02/146 datë: 31.03.2021 e parashtruar nga z. Ali Shala nga fshati Banjë, Komuna e Malishevës për mbështetje financiare për trajtim shëndetësor.

-Kërkesa nr.02/188 datë: 30.03.2021 e parashtruar nga Hnife Zabelaj fshati Ngucat

kërkesa nr.02/139 datë: 30.03.2021 e parashtruar nga z. Destan Kryeziu nga fshati Pagarushë Komuna e Malishevës, për mbështetje financiare për trajtim shëndetësor të bashkëshortes së tij të sëmurë zj.Bukurije Kryeziu.

-Kërkesa nr.02/124 datë:19.02.2021 e parashtruar nga z. Deli Sahiti nga fshati Panorc Komuna e Malishevës, për mbështetje financiare për trajtim shëndetësor të vajzës së tij të sëmurë znj.Fetije Sahiti.

-Kërkesa nr.02/104 datë: 16.03.2021 e parashtruar nga zj. Hajrije Morina nga fshati Astrazup , Komuna e Malishevës për mbështetje financiare për trajtim shëndetësor.

-Kërkesa nr.02/94 datë: 10.03.2021 e parashtruar nga zj. Ganimete Qatani me vendbanim në fshatin Banjë, Komuna e Malishevës për mbështetje financiare për trajtim shëndetësor.

-Kërkesa nr.02/78 datë: 02.03.2021 e parashtruar nga zj. Sahadete Lugu me vendbanim në fshatin Pagarushë, Komuna e Malishevës për mbështetje financiare për trajtim shëndetësor.

-Kërkesa nr.02/77 datë: 02.03.2021 e parashtruar nga z. Edmond S.Gashi nga fshati Kijevë Komuna e Malishevës, për mbështetje financiare për trajtim shëndetësor të djali të tij të sëmure Ledion Gashi.

Rrahim Morina: Pas leximit të gjitha kërkesave, a pajtoheni që të gjithëve të ju ndajmë nga 500 euro? Unanimisht të gjithë ishin për.

Ju përhëndes të gjithëve, ju falënderoj për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 13.50 min.

Procesmbajtësi

Naim Avdijaj jur. i dip

